

Universiteti i Mitrovicës - University of Mitrovica
“Isa Boletini”

Zyra për Sigurim të Cilësisë




**RAPORT PËRMBLEDHËS PËR
PYETËSORËT E REALIZUAR ME
PALËT E JASHTME TË INTERESIT**

Nëntor, 2020

Përmbajtja

Lista e shkurtesave	2
Hyrja	3
Zyra për Sigurim të Cilësisë	4
Realizimi i pyetësorit	5
Gjetjet e pyetësorit	6
Rekomandimet	14



Lista e shkurtesave

IAL:	Institucion i Arsimit të Lartë
KQSCV:	Komisioni Qendror për Sigurimin e Cilësisë dhe Vlerësimin
SEVC:	Sistemi Elektronik për Vlerësimin e Cilësisë
SMU:	Sistemi i Menaxhimit Universitarë
UMIB:	Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini”
ZSC:	Zyra për Sigurim të Cilësisë



Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini” (këtu e tutje: UMIB), si Institucion i Arsimit të Lartë (Këtu e tutje: IAL) themeluar që nga viti 2013, vazhdimisht ka bërë përpjekje që të bëjë të matshëm procesin e sigurimit të cilësisë. Për çdo vit, në UMIB janë organizuar pyetësorë me studentët dhe akterë tjerë relevant, të cilët janë përgjegjur në pyetjet të cilat kanë pasur për qëllim të tregojnë gjendjen reale në UMIB përmes përceptimit të respondentëve.


UMIB ka mekanizmat e tij për matjen e cilësisë, dhe përveç që procesi matet dhe monitorohet në vazhdimësi nga ana e dekanëve, prodekanëve, koordinatorëve për cilësi në kuadër të fakulteteve, Zyra për Sigurim të Cilësisë në Universitetin e Mitrovicës “Isa Boletini” (Këtu e tutje: ZSC) ka një rol të veçantë në këto zhvillime, dhe është organi kryesor brenda UMIB për matjen e cilësisë së brendshme.

I gjithë procesi, i hartimit të pyetësorëve, lansimit të tyre dhe i mbledhjes së të dhënave është bërë nga ZSC-ja në koordinim të plotë me KQSCV-në. Prosesi është transparent, dhe të gjithë pyetësorët kanë janë anonim duke respektuar kështu dinjitetin e secilit respondent dhe duke ruajtur prestigjin e institucionit, përjashtimisht pyetësorët e vetëvlerësimit.

Me qëllim që raporti të ruaj etikën e secilit dhe atë të institucionit, do të gjeni të publikuara vetëm disa nga gjetjet kryesore të pyetësorëve. Rekomandimet si pjesa e fundit e tij, do të përmbajnë edhe sugjerime e vërejtje të cilat nuk bëhen publike, por që janë dhënë nga ana e respondentëve.

Zyra për Sigurim të Cilësisë është zyrë e pavarur e cila funksionon brenda Rektoratit të Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini” (tutje UMIB) e cila raporton drejtpërdrejt te Rektori i UMIB-it. ZSC angazhohet në rritjen e cilësisë në UMIB duke zbatuar të gjitha politikat institucionale dhe instrumentat matës të cilësisë të aprovuar nga Komisioni Qendror për Sigurimin e Cilësisë dhe Vlerësimit (tutje KQSCV). Zyrtarët e cilësisë nuk janë pjesë e stafit akademik të UMIB-it.

Zyra kryen matje të cilësisë duke përdorur të gjitha instrumentet e përfshira në pakon e instrumenteve matëse të cilësisë e aprovuar nga KQSCV. ZSC harton raporte që përmbajnë gjetje dhe rekomandime për secilën pyetësor të realizuar të cilët i dërgon te Rektori i UMIB-it. Zyra gjithashtu i dërgon gjetjet dekanëve të njësive akademike me qëllim të planifikimit të zhvillimit të stafit akademik dhe përmirësimit të vazhdueshëm.



Pyetësori me palët e jashtme të interesit është një pyetësorë që realizohet një herë në vit në koordinim me të gjitha njësite akademike përmes koordinatorëve për cilësi.

Pyetësori me palët e jashtme të interesit është realizuar gjatë periudhës 10.09.2020 - 30.09.2020. Pyetësori ka qenë anonim dhe të dhënat janë mbledhur dhe ruajtur nga ZSC përmes Sistemit Elektronik për Vlerësimin e Cilësisë - SEVC.

Palët e jashtme të interesit janë përgjigjur përmes pyetësorit online (linkut) që ka qenë i lidhur me SMU-në. Pyetësori ka përmbajtur 9 pyetje të mbyllura dhe 6 pyetje të hapur, ku kanë vlerësuar bashkëpunimin me UMIB-in, fushat e bashkëpunimit, punësimi i studentëve, kënaqshmëria e aftësive dhe njohurive të studentëve, nevojat për lende dhe drejtime specifike etj.

Pyetjet kanë pasur për qëllim që të shohin këto aspekte kryesore:

- Punësimi i studentëve;
- Përgatitjet e studentëve për karrierë;
- Aftësitë dhe shkathtësitë e fituara të studentëve;
- Nevoja për lëndë dhe programe të reja të studimeve;
- Bashkëpunimi me UMIB-in;
- Fushat e bashkëpunimit;
- Sugjerimet dhe komentet;

Gjetjet e pyetësorit

Pyetësori është plotësuar nga palët e jashtme të interesit përmes linkut që ka qenë i lidhur me SEVC-in. Linku është shpërndarë përmes njësive akademike si dhe përmes platformave dhe grupeve të komunikimit me ta.

Nga të gjeturat kemi pranuar shumë komente dhe sugjerime që tregojnë interesimin e tyre që të kontribuojnë në proceset në UMIB. Ky raport shprehë vetëm statistikën e përgjithshme, dhe rekomandimet që dalin nga tërësia e përgjigjeve të marra.

Pyetësori me palët e jashtme të interesit është realizuar me të gjitha llojet e institucioneve përfshirë Institucionet shtetërore, ndërmarrjet publike, institucionet e arsimit, bizneset dhe organizatat jo qeveritare.

Pyetësorit ju kanë përgjigjur kryesisht institucionet nga regjioni i Mitrovicës dhe Prishtinës por duke mos anashkaluar edhe regjionet e tjera. Institucionet që janë përgjigjur pyetësorëve tonë janë kryesisht institucione që operojnë me shume se 10 vite në vendin tone.

Të gjitha institucionet kanë vlerësuar se pikat kryesore të misionit të UMIB-it që janë mësimdhënia cilësore, kërkimi shkencor dhe kontributi në komunitet janë përfaqësues të vlerave edhe të tyre.

Palët kanë renditur lehtësimet që kanë nga bashkëpunimi me UMIB-in të cilat i gjeni më poshtë të detajuara në raport. Po ashtu palët kanë renditur edhe vështirësitë e bashkëpunimit me UMIB dhe fushat se ku mund të zgjerohet bashkëpunimi.


64% e bizneseve kanë thënë që kanë punësuar staf që ka përfunduar studimet në UMIB dhe 79% janë të kënaqur me punën e tyre.

Palët e interesit që janë përgjigjur pyetësorëve tonë kanë dhënë vlerësim se 71% e tyre i kanë gjetur punëtorë në profilet që i ofron UMIB dhe 29% e tyre kanë thënë që UMIB nuk ka profile të edukimit për fushat që ata kanë interes.


Institucionet kanë dhënë drejtimet dhe lendet që janë me interes të jenë pjesë e UMIB-it të cilat janë specifikuar më tutje në raport.

Nga i gjithë pyetësori, institucionet kanë vlerësuar se 76% e tyre janë shumë të kënaqur me UMIB-in.


1. Lloji i institucionit




2. Lokacioni i Institucionit / Regjioni



3. Viti kur është themeluar Institucioni



4. Me cilët elemente të misionit të UMIB, përshtatet bashkëpunimi ynë.



5. Cilat janë disa nga lehtësimet që keni nga bashkëpunimi me UMIB?

- Praktikat e studentëve
- Bashkëpunimi profesional me stafin
- Hulumtimet shkencore
- Përgatitja e kuadrove të reja dhe profesionale
- Ngritja e kapaciteteve
- Shkëmbimi i përvojave
- Krijimi i pavarësisë profesionale
- Avancimi në njohuritë me makineri
- Diplomë e njohur ndërkombëtarisht
- Shkëmbim të informacioneve


6. Cilat janë disa nga vështirësitë që hasni në bashkëpunimet me UMIB?

- Aspektet financiare për projektet e përbashkëta
- Mungesa e themelimit të institutit hulumtues
- Vizitat e ndërsjella (jo të shpeshta)


7. Në cilat fusha mund të zgjerojmë bashkëpunimin?

- Sektori mineral
- Hulumtim dhe zhvillim të produkteve
- Sektori i prodhimit
- Praktikat e studentëve
- Punësimi i studentëve
- Sektori i përpunimit të verës


8. A keni punësuar anëtarë të stafit që ka përfunduar studimet në UMIB?



9. Sa jeni/keni qenë të kënaqur me punën e tyre?




10. A ka pasur raste që ju keni pasur nevojë për ndonjë punonjës të një profile të caktuar e që nuk keni mundur ta gjeni?



11. Cili profil i edukimit?

- Saldim
- Metalpunues
- Termo
- Mirëmbajtje në miniera, flotacion dhe metalurgji
- Hapja e më shumë drejtimeve Master dhe Doktoratë


**12. A ka ndonjë drejtim të studimit/lëndë të re që ju do të na
proponit ta vendosim në planprogramet e ardhshme të
Universitetit të Mitrovicës?**



13. Nëse po specifikoj drejtimin/lëndën?

- Gjeo-mjedisi
- Përdorimi i instrumenteve matëse si njonjusi apo edhe mikrometri
- Konvertimin e njësive matëse
- Teknologjia e verës
- Tekstili
- Inxhinieri e Ambientit
- Metalpunues
- Energji efiçente
- Softuer aplikativ
- Inxhinieri e hidraulikes dhe pneumatikes

14. Përshtypjet tuaja për Universitetin e Mitrovicës "Isa Boletini" si Institucion I Arsimit të Lartë?



Zyra e cilësisë e UMIB, pasi që ka shqyrtuar përgjigjet e palëve të jashtme të interesit, në këtë fazë të zhvillimit të institucionit, i rekomandon menaxhmentit të lartë të UMIB që të merren hapat si më poshtë:

- Të analizohen me kujdes nevojat dhe kërkesat e palëve të jashtme të interesit për lëndë dhe programe të reja;
- Të punohet në drejtim të hapjes së nivelit Master të studimeve;
- Të arrihen sa më shumë marrëveshje me palë të jashtme, vendore dhe ndërkombëtare për të mundësuar praktikë dhe punësim të studentëve;
- Të rritet kontributi për komunitetin përmes iniciativave të ndryshme;
- Të hapen institute hulumtuese në kuadër të UMIB-it dhe njësive akademike;
- Realizimi i vizitave më të shumta me institucione të ndryshme;

